



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 11.11.2020

FTESË PËR NEGOCIATA

Të nderuar,

Mbështetur në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, në Ligjin nr. 30/2016, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European në kuandër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit në fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi nga organet e administratës shtetërore”, si dhe në Urdhrin nr. 422, datë 23.10.2020, të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dërgon ftesën për ofertë organeve të masmedias/agjencive të specializuara me këtë përmbajtje:

- 1. Objekti i programit/spotit/reklamës:** Informimi mediatic i publikut lidhur me masat e mbështetjes së programit IPARD – II, thirrja e tretë, 2020.
- 2. Nevoja për kryerjen e reklamave:** Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur realizimi i objektit: “Për aktivitetet informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit IPARD – II, 2014 – 2020”.
- 3. Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spoteve/reklamave:** “Për informimin mediatic të publikut të gjerë, lidhur me implementimin e masave të mbështetjes për thirrjen e tretë të Programit IPARD II 2014-2020”, me fond limit 20.000.000 lekë me TVSH.
- 4. Ideimi i spoteve/reklamave të kryhet nga organet e masmedias të specializuara në këtë fushë dhe transmetimi të kryhet në TV Kombëtare, Lokale, nga masmedia on-line, printime Roll up baners, reklamim në Facebook, printim fletëpalosje katër faqe, printim**

posterash një faqe, printim Udhëzues 200-250 fletë, 2 video animacion, organizim i aktiviteteve promovuese në qarqe etj.

5. Objekti i programit të spoteve/reklamave për sektorët që do të mbështeten, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, është si më poshtë:

1. TV- Spote për dy masat e IPARD II

Numri i spoteve (reklama) me xhirime që do të realizohen, do të jetë 1 (një).

Gjatësia kohore e spotit është; jo më pak se 45 sekonda.

Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboarding e spotit.

Spoti duhet të përmbajjë xhirime cilësore (HD).

Regjistrimet dhe prodhimi i spotit duhet të përfshijë: sekuenca, plane detaje, të përgjithshme, elemente grafike, të shoqëruara me titra, pamje që tregojnë gjeografinë e vendndodhjes, filmime në lartësi, plane me dron, close-up, etj.

- Sekuenca ku integrohet prezenca njerëzore, si dhe e specialiteteve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.
- Komplekse blegtoriale, kullota, plane në perspektivë, që tregojnë zhvillimin rural.
- Pamje kodrinore apo fusha të mbjella me kultura bujqësore, sera, industri përpunimi, linja përpunimi, prodhimi, paketimi, tregtimi etj.
- Sekuenca që tregojnë infrastrukturë të ngritur, shkëmbime tregtare, investime në agropërpunim, linja përpunimi, paketim, tregtim etj.
- Kohëzgjatja e transmetimit publik duhet të jetë 12 ditë (Transmetimet duhet të jenë gjatë audiencës maksimale para edicionit të Lajmeve në televizionin Publik dhe ato Lokale).

Audio dhe kolona zanore e spotit duhet të jetë cilësore me parametra 48 khz dhe 24-bit depth.

Efektet audio dhe efektet muzikore që do të shoqërojnë spotet të zoterojnë të gjitha të drejtat e përdorimit pa limit në hapësirë gjeografike apo kohore.

Spoti do të shoqërohet me voiceover dhe/ose me titra.

Spoti duhet të shoqërohet me sloganin kryesor dhe logot zyrtare të MZHBR, AZHBR dhe logo IPARD.

Spoti duhet të shoqërohet me adresën e faqes zyrtare të internetit të MZHBR dhe AZHBR.

Operatori siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme, lëvizjet, stafin dhe lejet për filmime në vendndodhje të ndryshme.

Produkti final duhet të jetë format video HD 1080, si dhe të dorëzohet në format dixhital (USB).

Afati i prodhimit 7 ditë pune nga lidhja e kontratës.

2. Video trajnuese për mënyrën e aplikimit për grantet e IPARD

Prodhim i 2 (dy) video trajnuese “motion-graphic”, gjatësia e seciles video duhet të jetë jo më e vogël se 1 (një) minutë, ne varesi të materialit të dhene nga AZHBR. Operatori merr përsipër të

krijojë konceptin, skenarin dhe storyboardin e videos trajnuese. Cilësia e videove duhet të jetë e standartit HD (High Definition).

Të përmbajë imazhe grafike shpjeguese (motion-graphic, slide, etj) sipas nevojës.

Audio dhe kolona zanore duhet të jetë cilësore me parametra 48 khz dhe 24-bit depth.

Efektet audio dhe baza muzikore që do të shoqërojnë videon trajnuese të zotërojnë të gjitha të drejtat e përdorimit pa limit në hapësirë gjeografike apo kohore.

Video do të shoqërohet me “voiceover” dhe mesazhi të jetë i sintetizuar, dhe/ose i shoqëruar me titra. Videot duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të MZHBR, AZHBR dhe IPARD, si dhe adresën e internetit përkatëse.

Operatori siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin.

Produkti final duhet të jetë format video HD 1080, si dhe duhet të dorëzohet në format dixhital CD ose USB.

Afati i prodhimit 7 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës.

Shërbimet, komponentët dhe grafiku i ekzekutimit

1. Fletëpalosje (me një palosje) A4 me specifikime, copë 10.000 si më poshtë:

- Përmasa A4;
- Printimi nga të dyja anët;
- Palosje në mes (horizontale);
- Me ngjyra
- Pesha jo më pak se 150 gr/m²;

2. “Udhëzuesi për Aplikantët” (manual), copë 1000 si më poshtë:

- Përmasa A4
- Nr. i faqeve 200-250 (me kopertinë)
- Kopertina me ngjyra;
- Faqet e broshurës bardh e zi;
- Pesha e letrës faqet e brendshme 90 gr/m²;
- Pesha e letrës së kopertinës 300 gr/m²;

3. Postera me specifikime si më poshtë, copë 200

- Përmasa 50x70 cm;
- Printim me ngjyra;
- Nr i layout-eve për të 2 (dy) Masat e IPARD-II;
- Pesha e letrës 150 gr/m²;

4. Roll up me specifikime si më poshtë:

- 20 copë;
- Përmasa 80 x 200 cm;

- Printim me ngjyra (nga një anë);
5. Organizimi i Eventeve të shpalljes së thirrjes së tretë për aplikime në programin IPARD-II, të dhëna/specifikime si më poshtë:
- Do të organizohen në total 12 (dymbëdhjetë) aktivitete në qarqet: Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Berat, Vlorë, Elbasan, Korçë, Tepelenë, Gjirokastrë dhe Kukës;
 - Shërbimi kërkohet të jetë në ambient të hapur (outdoor), duke respektuar rregullat dhe aktet ligjore e nënligjore të vendosura nga Institucionet për COVID 19,
 - Vendndodhjet e eventit:
 - të jetë për 20-30 persona të ulur (karrike të disponueshme);
 - të ketë të instaluar sistem audio, pajisje të nevojshme si dhe të ofrohen dhe dy mikrofona valor për diskutime nga të pranishmit.
 - asistencë teknike gjatë gjithë takimit.
6. Reklamim në Facebook (AZHBR) me qëllim arrijen e 100.000 views në ditë- shpeshësia e « boost » jo më pak se 2 (dy) herë në ditë.
7. Monitorimi i të gjithë procedurës së ndjekur nga kompani të specializuara që ushtrojnë këtë aktivitet, dhe monitorimin e të gjithë praktikës së publicitetit.

TERMAT E REFERENCËS

1. Fletëpalosje:

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, tekstin dhe layout-in grafik të fletëpalosjes;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë: slogan, tekst, logo;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik (nëse kërkohet) për fletëpalosjen;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë logon e MZHBR, AZHBR si dhe projektit IPARD;
- Afati i prodhimit 7 ditë nga nënshkrimi i kontratës;

2. Broshurë:

- Broshura libër “Udhëzuesi për Aplikantët” duhet të përmbajë: fotografi, slogan, tekst;
- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, tekstin dhe layout-in grafik të broshurës;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik (nëse kërkohet) për broshurën;
- Broshura duhet të përmbajë logon e MZHBR, AZHBR si dhe projektit IPARD;
- Afati i prodhimit 7 ditë nga nënshkrimi i kontratës;

3. Poster:

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, tekstin dhe layout-in grafik të posterit, me kompozim të ndryshëm për dy masat mbështetëse të thirrjes së tretë të Programit IPARD.
- Posterit duhet të përmbajë: fotografi, slogan, tekst;

- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për posterin.
- Posteri duhet të përmbajë logon e MZHBR, AZHBR si dhe projektit IPARD;
- Afati i prodhimit 7 ditë nga nënshkrimi i kontratës;

4. Roll up:

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, tekstin dhe layout-in grafik të posterit.
- Banneri duhet të përmbajë: fotografi, slogan, tekst;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për posterin.
- Posteri duhet të përmbajë logon e MZHBR, AZHBR si dhe projektit IPARD;
- Afati i prodhimit 7 ditë nga nënshkrimi i kontratës;
- 2 roll up (2x0.8m) me strukturë metalike, që do të përdoren në të gjitha aktivitetet e planifikuara;

5. Organizimi i aktiviteteve:

- Aktivitetet do të zhvillohen gjatë periudhës së muajit Nëntor-Dhjetor 2020.
- Operatori ekonomik merr përsipër transportin e materialeve të përcaktuara sa më sipër si karrige, banner, stafin e promocionit, etj;
- Operatori ekonomik merr përsipër organizimin e aktiviteteve përkatëse sipas specifikimeve teknike;

6. Reklamim në Facebook, me qëllim arritjen e 100.000 përdorues në ditë- shpeshësia e « boost » - it jo më pak se 2 (dy) herë në ditë.

7. Vlera e kontratës së shërbimit do të jetë: jo më shumë se 40%, ideim, krijim, prodhim i spoteve/reklamave dhe pjesa tjetër prej 60% e mbetur do të jetë për transmetimin sipas media planit.

8. Buxheti të paraqitet i veçantë dhe i detajuar për ideimin/produksionin, post-produksion, grafik design, dhe për transmetimin dhe monitorimin.

9. Të paraqitet një projekt ide-skenar për realizimin e spotit me tematikat e mësipërme në CD;

10. Ana grafike dhe regjizoriale e spotit dhe çdo elementi të tij duhet të jetë në përputhje me rregullat e përgjithshme dhe legjislacionin për reklammat.

11. Monitorimi i gjithë procedurës së ndjekur nga kompani të specializuara që ushtrojnë këtë aktivitet, në monitorimin e të gjithë praktikës së publicitetit.

12. Afati i realizimit të shërbimeve si më sipër do të jetë deri në fundim të thirrjes për aplikime nga Programi IPARD II.

Fondi limit është 20.000.000 lekë me TVSH.

➤ **Dokumente ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Ekstrakt historik i QKR, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv
- Dokument nga organet kompetente që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën koherente
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 viteve 2017-2018-2019.
- Vërtetim për numrin e punonjësve për periudhën Shtator 2019- Shtator 2020
- Deklaratë për nënshkrimin e specifikimeve teknike, deklaratë mos pasjen e konfliktit të interesit.
- Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore, ku shprehet se Operatori ekonomik nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, që lidhet me aktivitetin profesional.

➤ **Dokumentacioni financiar, si kriter kualifikues**

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN
- Kontratë të ngjajshme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (faturat përkatëse dhe/ose kontrata).
- Sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së fondit limit
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi;
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës, deklaratën e konfidencialitetit.
- Formularin e ofertës
- Media plan paraprak për shpërndarjen/transmetim
- Deklaratën nga operatori ekonomik që tranmetimi i reklamës do të jepet nga organet e medias, të cilat janë aktive dhe të licensuara sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteret e vlerësimit të subjekteve janë :

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë; Projekt-ideja e realizimit të spoteve/reklamave, e cila përmban idejim/krijim, regji, montazh, efekte vizive dhe audio, stafi aktorëve, stafi ndihmues, etj

Projekt ideja do të vlerësohet nga Komisioni, në varësi të projekt idesë më të mirë të paraqitur.

Vlerësohet me 30 (tridhjetë) pikë; Koha televizive e blerë për transmetimin e Spoteve/reklamave (sipas logjikës së formulës më poshtë).

KT- Koha Televizive

KTM- Koha televizive me e madhe

KTV- Koha Televizive e që vlerësohet

$$KT = \frac{30 * KTV}{KTM}$$

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë; oferta më e ulët ekonomike në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta (sipas logjikës së formulës më poshtë).

OE- Oferta ekonomike
OU- Oferta më e ulët
OV- Oferta që vlerësohet

$$OE = \frac{35 \times OU}{OV}$$

-Vlerësimi përfundimtar = pikët për projekt idenë + pikët për Kohën televizive + pikët për ofertën ekonomike.

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj.

Mbi zarf të jetë shënuar **“ofertë për shërbimin”**. Përzgjedhja e ofertave do të realizohet sipas VKM nr. 1195, datë 5.8.2008, dhe kriterëve të përshkruara dhe metodologjisë me sistemin e pikëve.

Monitorimi i publicitetit do të kryhet sipas përcaktimeve që do të vendosen në kontratën e shërbimit ndërmejt palëve.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë AZHBR në datën **16.11.2020 ora 10:00**.

Në procesin e hapjes së ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë Ofertuesit, apo personat me autorizim.

Komisioni pret konfirmimin nga organet e masmedias/të Agjencive të specializuara për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, organet e masmedias/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.